



Pranuar / Dorezuar Prilijeno/Prodato Received/Delivery	13.10.2022	2 viti god year	
Organ /Njesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Rr. Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHICK	6170/2022		1/5



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.740/2022

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.740/2022 të datës 29.08.2022 të parashtruar nga grupi i ankuesve te përfaqësuar nga ankuesja me autorizim,

në Komunë të Prishtinës, kundër organit të punësimit/Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, në çështjen juridike-administrative **“kompensim material”**, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 12.10.2022, mori këtë:

V E N D I M

**HEDHET POSHTË si e pa lejuar** ankesa me numër A.nr.740/2022 e datës 29.08.2022 e parashtruar nga ankuesja

**Arsyetim**

Ankuesit:

nëpunësit

Arsimit, të cilët me autorizim i përfaqëson ankuesja, e punësuar në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, sipas Akt emërimit të datës 04.05.2012, në pozitën “Inspektore e Arsimit” në Departamentin e Inspektoratit të Arsimit me datë 29.08.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me numër protokollit 5005/2022, me pretendime ankimore për realizimin e të drejtës për pagesën shtesë në mënyrë retroaktive nga muaji janar 2019 deri me nëntor

2021, për rrezikshmërinë për kushtet specifike të punës, në bazë të nenit 26 të Ligjit Nr.06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 31.08.2022, ankesën e ankueseve e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, ndërsa Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, me datë 12.09.2022 dhe të plotësuar me datë 16.09.2022, ka dërguar në Këshill, përgjigjen ne ankese me të gjitha shkresat e bashkangjitura.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova:** Ankesën e datës 29.08.2022 me numër protokolli 5005/2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimi i ankueses i datë 26.08.2022 të bashkangjitur Listat e ankuesve, prej 1/8 faqe; shkresë e datës 16.08.2022 nga Autorizim nga Kërkesë për pagesa retroaktive e datë 10.10.2020 nga Lista e inspektorëve të arsimit për vitin 2019, Autorizimi i datës 22.08.2022; Kërkesë për pagesa retroaktive e datë 31.03.2020 nga Përgjigje ne ankese e datë 12.09.2022; Provë Ligji Nr.06/L-046; Formulari shpenzimit te departamentit te datës 12.02.2019; Formulari shpenzimit te departamentit te datës 21.02.2020; Formulari shpenzimit te departamentit te datës 19.10.2021; Kërkesë e datës 21.02.2019 me numër ref. 10/162; E-mail e datës 25.02.2019 Kërkesë për realizimin e kompensimit të pagës së rrezikshmërisë nga z.D.G; Email i datës 25.02.2019 nga z.I.LL; Kërkesë e datës 26.02.2019 me numër ref. 10/166 me listën e bashkangjitur të nëpunësve; E-mail i datës 26.02.2019 nga z.I.LL; Kërkesë e datës 05.03.2019 me numër ref. 10/195 prej 1/3 faqe; Plotësim shënim për Kërkesë e datës 08.03.2019 me Nr.ref10/221 prej 1/3 faqe; Ripërtëritë e kërkesës me datë 03.04.2019 me numër ref.10/nr.303 nga z.D.G prej 1/3 faqe; E-mail i datës 03.05.2019 nga z.R.Z, për z.D.G, me temën sqarime; Kërkesë e datës 02.09.2019 me nr.ref.10/785 prej 1/3 faqe; Kërkesë për realizimin e shtesës e datës 04.11.2019 me nr. Ref.10/1093 prej 1/2 faqe; Kërkesë për realizimin e shtesës e datës 19.08.2019 me nr. Protokolli 2403, nr.Ref.10/05 , prot.441/2019; Përgjigje e datë 26.08.2019 me nr. Protokolli 2403/2;Ankesë për mos realizimin e shtesës e datës 04.11.2019 me nr. Ref.10/nr.1094 prej 1/3 faqe; Kërkesë për realizimin e shtesës e datës 23.01.2020 me nr. Protokolli 084 prej ½ faqe; Përgjigje në lëndën me nr. Prot.084 të datës 23.01.2019, e protokolluar me nr.03412 me datës 28.01.2020; Përsëritje e kërkesës e datë 20.05.2020 me nr. Ref.10/nr.329 prej 1/3 faqe; Kërkesë e datës 15.06.2020 me numër ref. 10/nr.373 prej 1/3 faqe; Miratimi i kërkesës nr. Ref.10/nr.373 e dt.15.06.2020, e datës 02.11.2020, me nr. Ref.10 nr. Prot.786; Kërkesë e datës 29.03.2021; Kërkesë e datës 23.06.2021 me nr. Protokolli 101; Kërkesë e datës 15.11.2021 nr. Ref.10/nr.1120; Kërkesë e datës 15.11.2021 nr. Ref.10/nr.1121; Vendim i datës 07.12.2021 nr.01B/350;Vendimi Anr. 229/2022 e datës 12.05.2022 i KPMSHCK-së prej 1/7 faqe; Kërkesë e datës 07.12.2021 me nr. Ref.10/nr.1223 me listë të bashkangjitur; E-mail i datës 07.12.2021 nga z.D.G; E-mail i datës 16.12.2021 nga ankuesja drejtuar z.A.I; E-mail i datës 14.12.2021 nga z.I.LL drejtuar znj.A.K; E-mail i datës 14.12.2021 nga z.A.I. për z.D.G; E-mail i datës 07.12.2021 nga z.D.G për z.A.I; Shkresë-Sqarim i datë5.12.2021 nr. Ref.10/1274; Informatë e datë 10.12.2021 nr. Ref.10/nr.1262 ; Akt emërim i datës 07.10.2016; Akt emërim i datës 03.05.2012; Akt emërim i datës 04.05.2012; Akt emërim i datës 06.06.2012; Akt emërim i datës 20.02.2017; Akt emërim i datës 11.05.2012; Akt emërim i datës 27.04.2018; Akt emërim i datës 11.05.2012; Akt emërim i datës 07.05.2013; Akt emërim i datës 11.05.2012; Akt emërim i datës 17.01.2014; Akt emërim i datës 24.01.2017; Akt emërim i datës 10.05.2012; Akt emërim i datës 10.05.2012; Akt emërim i datës 03.08.2016; Akt emërim i datës 03.08.2016; Akt emërim i datës 30.11.2011; Akt emërim i datës 01.06.2012; Akt emërim i datës 01.06.2012; Akt emërim i datës 03.08.2016; Akt emërim i datës 11.05.2012; Akt emërim i datës 11.05.2012; Akt emërim i datës 17.01.2014; Akt emërim i datës 11.05.2012; Akt emërim i datës 24.10.2011; Akt emërim i datës 11.05.2012; Akt emërim i datës 11.05.2012; Akt emërim i datës 18.04.2012; Akt emërim i datës 11.05.2012; përshkrim i detyrave të punës pa datë prej 1/9 faqe, dhe

LOS  
KOSOVË  
KOSOVIA

përgjigje në ankesë me prova shtesë e datës 16.09.2022 me nr.protokolli5470/22 prej1/7 faqe, të bashkangjitur listat e pagave nga data 01.08.2022 deri me datë 31.08.2022 për ankuesit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesat e grup-ankuesve të përfaqësuar nga ankuesja **është e pa lejuar, sepse:**

Ankuesit 1. e punësuar në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, sipas Akt emërimit të datës 04.05.2012, “Inspektore e Arsimit”, në Departamentin e Inspektoratit të Arsimit, i punësuar në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, sipas Akt emërimit të datës 07.10.2016, në pozitën “Drejtori i Përgjithshëm i Inspektoratit”, në Departamentin e Inspektoratit të Arsimit, i punësuar në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, sipas Akt emërimit të datës 10.05.2012, në pozitën “Inspektor për nivelin 6-9 në Mitrovicë”, në Departamentin e Inspektimit të Arsimit, i punësuar në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, sipas Akt emërimit të datës 30.11.2011, në pozitën “Udhëheqës i Sektorit të Inspektimit të Arsimit – (SIA)-Pejë, në Departamentin e Inspektimit, i punësuar në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, sipas Akt emërimit të datës 24.01.2017, në pozitën “Inspektor i Arsimit SIA-Prizren”, në Departamentin e Inspektoratit të Arsimit, i punësuar në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, sipas Akt emërimit të datës 03.08.2016, në pozitën “Inspektore Arsimit në Qendrën e Inspektoratit të Arsimit në Ferizaj”, në Departamentin e Inspektoratit të Arsimit, i punësuar në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, sipas Akt emërimit të datës 11.05.2012, në pozitën “Udhëheqës i Sektorit të Inspektimit të Arsimit –Gjilanë”, në Departamentin e Inspektoratit të Arsimit, e punësuar në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, sipas Akt emërimit të datës 03.05.2012, , në pozitën “Inspektore e Arsimit”, në Departamentin e Inspektoratit të Arsimit, e punësuar në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, sipas Akt emërimit të datës 06.06.2012, në pozitën “Inspektore e Arsimit”, në Departamentin e Inspektoratit të Arsimit, e punësuar në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, sipas Akt emërimit të datës 20.02.2017, në pozitën “Inspektore e Arsimit”, në Departamentin e Inspektoratit të Arsimit, e punësuar në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, sipas Akt emërimit të datës 11.10.2021, në pozitën “Inspektore e Arsimit në Sektorin e Inspektoratit të Arsimit SIA për Prishtinë”, në Departamentin e Inspektoratit të Arsimit, i punësuar në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, sipas Akt emërimit të datës 10.05.2012, në pozitën “Inspektor për Arsim Profesional-Mitrovicë”, në Departamentin e Inspektimit të Arsimit i punësuar në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, sipas Akt emërimit të datës 03.08.2016, në pozitën “Inspektor i Arsimit në Qendrën e Inspektoratit të Arsimit-Mitrovicë”, në Departamentin e Inspektoratit të Arsimit, e punësuar në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, sipas Akt emërimit të datës 01.06.2012, në pozitën “Inspektore për Nivelin 0-5, dhe Arsimin e Komuniteteve në Pejë”, në Departamentin e Inspektoratit të Arsimit, i punësuar në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, sipas Akt emërimit të datës 01.06.2012, në pozitën “Inspektor i Arsimit në Pejë”, në Departamentin e Inspektimit të Arsimit, i punësuar në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, sipas Akt emërimit të datës 17.01.2014, në pozitën “Inspektor i Arsimit - Prizren”, në Departamentin e Inspektimit të Arsimit, i punësuar në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, sipas Akt emërimit të datës 07.05.2013, në pozitën “Inspektor i Arsimit për Komunitete SIA-Prizrenë”, në Departamentin e Inspektimit të Arsimit, i punësuar në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, sipas Akt emërimit të datës 11.05.2012, në pozitën “Inspektor i Arsimit –Prizrenë”, në Departamentin e Inspektimit të Arsimit, i punësuar në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, sipas Akt emërimit të datës 11.05.2012, në pozitën “Inspektor i Arsimit -Prizrenë”, në Departamentin e Inspektimit të Arsimit,

i punësuar në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, sipas Akt emërimit të datës 11.05.2012, në pozitën “Inspektor për Nivelin 6-9 për Arsim të Komuniteteve dhe të Drejtave të Njeriut në Gjuhën Boshnjake-Prizrenë”, në Departamentin e Inspektimit të Arsimit, i punësuar në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, sipas Akt emërimit të datës 11.05.2012, në pozitën “Inspektore për nivelin 0-5dhe Arsimit të Komuniteteve -Gjilanë”, në Departamentin e Inspektoratit të Arsimit i punësuar në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, sipas Akt emërimit të datës 27.04.2018, në pozitën “Inspektor i Arsimit ”, në Departamentin e Inspektoratit të Arsimit, si dhe ish i punësuar në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, sipas Akt emërimit të datës 11.05.2012, në pozitën “Inspektor për Nivelin 6-9 në Gjakovë”, në Departamentin e Inspektimit të Arsimit, i pensionuar me datën 01.05.2022, 2. ish i punësuar në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, në pozitën “Inspektor i Arsimit ”, i pensionuar me datën 06.05.2021, ish e punësuar në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, në pozitën “Inspektor i Arsimit ”, i pensionuar me datën 01.06.2021, ish i punësuar në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, në pozitën “Inspektor i Arsimit ”, i pensionuar me datën 05.02.2022, ish i punësuar në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, në pozitën “Inspektor i Arsimit ”, i pensionuar me datën 01.01.2022, ish i punësuar në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, në pozitën “Inspektor i Arsimit ”, i pensionuar me datën 10.10.2020, ish i punësuar në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, në pozitën “ish Udhëheqës i Sektorit te Inspektoratit të Arsimit në Mitrovicë”, i pensionuar me datën 01.04.2020, 8. i punësuar në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, i transferuar nga pozita “Inspektor i Arsimit” ne pozitën e „Zyrtarit te larte per Arsimin e larte Privat “ne Departamentin e Arsimit te Larte dhe ish Udhëheqës i Sektorit te Inspektoratit të Arsimit në Ferizaj, i transferuar ne pozitë tjetër me datën 01.09.2020, të cilët me autorizim i përfaqëson në datë 29.08.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 5005/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimore për realizimin e te drejtës për pagesën shtesë në mënyrë retroaktive nga muaji Janar 2019 deri në muajin Nëntor 2021, për rrezikshmërinë për kushtet specifike të punës në bazë të nenit 26 te Ligjit 06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës ( Gusht 2018 – Gazeta Zyrtare nr.13/gusht 2018),gjegjësisht prej kur ka hyr në fuqi Ligji i Inspektoratit të Arsimit në Republikën e Kosovës dhe hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.06/L-133 mbi Ndarjen Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2019.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave bazuar në provat e lëndës ka konstatuar se ankuesit për realizimin e kësaj të drejte nuk i janë drejtuar paraprakisht me kërkesë organit të punësimit, respektivisht udhëheqësit me të lartë administrativ si organ kompetent për trajtimin e kësaj çështje, kështu që lidhur me këtë objekt të ankesës nuk kemi veprim apo mosveprim të organit të punësimit në raport me të drejtën e pretenduar në ankesë, për çka ankuesja mund të kontestonte ligjshmërinë e veprimit të organit te punësimit, apo mosveprimin e tij, siç parashihet me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 24 paragrafi 3 ku përcaktohet se: 3. *Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil, si dhe dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht neni 124 ku përcaktohet se: 1. Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim. Çështja e parashtrimit te ankesës kundër vendimit te organit të punësimit është e përcaktuar edhe me nenin 16 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.*

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave bazuar në provat e lëndës ka konstatuar se ankuesja si përfaqësuese e autorizuar me asnjë provë nuk e ka dëshmuar se ka parashtruar kërkesë tek organi i punësimit,

respektivisht nuk ka dëshmuar se ka parashtruar kërkesë tek Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, siç përcaktohet me dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht me nenin 73 paragrafin 1 dhe 3 si dhe nenin 74 paragrafi 1 të këtij ligji.

Andaj, meqenëse ankuesit në këtë procedurë nuk kanë parashtruar fillimisht kërkesë pran organit të punësimit, Kolegji vlerëson se nuk janë përmbushur kushtet për pranueshmëri të ankesës, siç përcaktohet me nenin 129 paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.704/2022.

Zyle Millaku Gojnovci

Procesmbajtëse

Malsore Gashi BAJRAKTARI,

Kryetare e Kolegjit

### Vendimi i dërgohet:

- Ankueses *përfaqësuese e autorizuar (për grupin e ankuesve);*
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë;
- Udhëheqësit të Personelit në Inspektoratin e Arsimit në Ministrinë e Arsimit Shkencës,
- Arkivit të KPMSHCK-së.